



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Gjykata Kushtetuese - Ustavni sud - Constitutional Court**

---

Perandori Justinian p.n., Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 220 104; Fax: +381 (0)38 220 112  
www.gjk-ks.org

Prishtinë, datë: 19 nëntor 2009  
Ref.: RK – 02/09

**VENDIM**

(Refuzim i Kërkesës /RK/ për Rastin KI 09/09 "Haxhi Thaqi versus Këshilli Gjyqësor i Kosovës")

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duke vepruar përmes Kolegjit Shqyrtues në përbërje:

- Gjyqtarja Snezhana Botusharova, kryesues
- Gjyqtari Ivan Çukaloviç, anëtar
- Gjyqtari Altay Suroy, anëtar

me procesmbajtës zt. Naser Hasani, Drejtor i Departamentit për Regjistrim të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv, dhe zt. Kadri Kryeziu si gjyqtar raportues për rastin, në këshillimin e datës 27 tetor 2009, ka marrë në shqyrtim rastin Nr. 09/09, "Haxhi Thaqi versus Këshilli Gjyqësor i Kosovës", të regjistruar më 5 mars 2009, me këto të dhëna:

**Kërkues:** Haxhi Thaqi nga fshati Damjan i Gjakovës, Kosovë, i përfaqësuar vet.

**Pala kundërshtare :** Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), i përfaqësuar nga zt. Isa Hasani, u.d. i Udhëheqësit të Zyrës Ligjore në KGJK .

**Objekti i shqyrtimit:** Vlerësimi i kushtetutshmërisë së bazës ligjore për nxjerrjen Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 të datës 27 nëntor 2008 të KGJK .

**Baza juridike :** Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (KRK); neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (LGJKRK); dhe nenet 34 dhe 35 të Rregullores mbi Punën e Gjykatës Kushtetues të Republikës së Kosovës (RRPGJKRK).

Më datën 5 mars 2009, Kërkuesi ka paraqitur kërkesën e tij me të cilën ka kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së bazës juridike për nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 të datës 27 nëntor 2008 të KGJK "Mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore".

Mbrojtja e kërkuar konsiston në kërkesën e Kërkuesit për shfuqizim të Udhëzimit Administrativ sa më sipër.

Kërkuesi po ashtu ka kërkuar që Gjykata të lejojë vënien e masës së përkohshme me të cilën do të pezullohej zbatimi i mëtejshëm i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2, si dhe Letra Qarkore Nr. 2008/2, e lëshuar nga Drejtori i Sekretariatit të KGJK deri sa të vendoset meritorisht mbi kërkesën primare.

Më datën 11 gusht 2009, Sekretariati i Përkohshëm i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (GJKRK) ka proceduar me kërkesën e palës kërkuese duke i kërkuar palës kundërshtare që të japë përgjigje me shkrim konform nenit 22.2 të LGJKRK.

Pala kundërshtare ka paraqitur përgjigjen e vet Nr. Ref/09/031-934 më datën 14 gusht 2009.

Më 28 gusht 2009, Kryetari i GJKRK me vendimin Nr. GJRap.02/09 ka emëruar për gjyqtarin raportues të rastit, si dhe kolegjin shqyrtues, në pajtim me një sistem të përcaktimit të rastësishëm të rasteve të cilin e zbaton GJKRK.

Më 9 nëntor 2009, Gjyqtari Raportues ka dhënë raportin e vet për Kolegjin Shqyrtues i cili ka shqyrtuar të njëjtin më datën 25 shtator 2009 me dyer të mbyllura.

Kërkuesi ka pohuar se nxjerrja e Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/03 "Mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore" të KGJK është në kundërshtim me nenin 119.8 të KRK, në të cilin parashikohet se "...çdo person duhet të paguajë taksat dhe kontributet të tjera të parapara me ligj".

Kërkuesi ka theksuar se taksat mund të vihen vetëm në bazë të ligjit të cilin e ka nxjerrë Kuvendi i Kosovës. Për pasojë, Kërkuesi pretendon se KGJK nuk ka mandate për nxjerrjen e instrumenteve juridike me të cilin vihen taksat. Për më tepër, sipas Kërkuesit Kuvendi i Kosovës si organi më i lartë ligjvënës në Kosovë mban të drejtën ekskluzive për nxjerrjen e ligjeve me të cilat parashikohet vënia dhe mbledhja e taksave.

Kërkuesi nuk ka provuar se të drejtat dhe liritë e tij individuale janë cenuar si rezultat i nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ të sipër cekur, e as që ka provuar të drejtën e tij.

Kërkuesi po ashtu nuk ka dhënë bazat juridike mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij për vënien e masës së përkohshme, ashtu siç kërkohet nga neni 27 i LGJKRK dhe neni 51.2 i RRPJKRK.

Në përgjigjen e vet pala kundërshtare ka theksuar se Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/2 i KGJK është në pajtim me KRK sepse si i tillë është nxjerrë në bazë të Urdhëresës Administrative 2008/4 të UNMIK-ut të datës 30 prill 2008 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/52 "Mbi themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës" të datës 20 dhjetor 2005. Për pasojë, pala kundërshtare ka thënë se KGJK është në tërësi i autorizuar me këto instrumente juridike të UNMIK-ut për "zhvillimin e një skeme uniforme të taksave gjyqësore dhe shpenzimeve të tjera procedural të vëna nga gjykatat e Kosovës".

Nga sa më sipër, sipas palës kundërshtare, Udhëzimi administrativ Nr. 2008/2 i KGJK është në tërësi në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovës dhe se është nxjerrë nga autoriteti kompetent, pra nga KGJK.

## GJYKATA KUSHTETUESE

në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 6 të LGJK dhe nenet 34 dhe 35 të RRPGJKRK ka nxjerrë vendimin Nr. GJRap. 02/09, datë 28 gusht 2009, me të cilin ka caktuar zt. Kadri Kryeziu si gjyqtar raportues të rastit, dhe vendimin Nr. KShqyr. 01/09, datë 28 gusht 2009, mbi caktimin e Kolegjit Shqyrtues në përbërje: gjyqtarja Sezhana Botusharova, kryesuese, gjyqtari Ivan Čukalović, anëtar, dhe gjyqtari Altay Surroy, anëtar;

pasi ka dëgjuar raportimin e gjyqtarit raportues dhe pasi ka shqyrtuar të njëjtin raport pa prezencën e publikut me datën 25 shtator 2009,

### VËREN

Se ka dy çështje thelbësore të cilat kërkojnë adresim me qëllim që të vihet deri të një vendim për lejueshmërinë e Kërkesës. Kjo do të thotë se Gjykata duhet të përcaktojë nëse Kërkuesi ka një *locus standi* për të paraqitur një kërkesë të kësaj natyre, si dhe të përcaktojë nëse Kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë pas shterjes së mjeteve tjera juridike nga ana e Kërkuesit.

Lidhur me *locus standi* për paraqitjen e një rasti të tillë në këtë Gjykata, Gjykata vëren se përkundër faktit që Kërkuesi thirret në nenin 113.7 të KRK si bazë për paraqitjen e kërkesës së tij, Kërkuesi nuk ka dhënë asnjë provë më të cilin mund të provohet se nxjerrja e instrumenteve të kontestuara juridike nga ana e KGJK ka rezultuar në cenimin e të drejtave dhe lirive të tij njerëzore.

Sipas nenin 113. 7 të KRK, e drejta e individëve për vënien në lëvizje të GJKRK bazohet në cenimin e provuar të një të drejte dhe lirie njerëzore nga ana e veprimeve të autoriteteve publike. Ky parakusht është në pajtim me nenin 34 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, e cila thotë:

“Gjykata mund të pranojë kërkesa nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh të cilët pohojnë se janë viktimë e cenimit nga ana e palëve kontraktuese të të drejtave të parapara me Konventë dhe protokollet e saj. Palët kontraktuese zotohen se nuk do të pengojnë në asnjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte”.

Në mungesë të këtij elementi, kontrolli kushtetues i akteve të autoriteteve publike bie në kuadër të të ashtuquajturit kontroll abstrakt i kushtetutshmërisë. Kjo e drejtë sipas KRK, u njihet vetëm atyre entiteteve dhe grupeve të cilat numërohen shprehimisht në nenin 113 , paragrafët 2, 3, 4, 5, 6, 8 dhe 9.

Në dritën e kësaj që u tha këtu, Gjykata konsideron se kjo Kërkesë duhet të deklarohet si e *palejueshme* meqë Kërkuesi nuk ka legjitimitet aktiv për të nisur pranë kësaj Gjykate procedurat e tilla të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë.

Pa marrë parasysh faktin që Gjykata konsideron se Kërkesa duhet të deklarohet si e *palejueshme* për mungesë legjitimitetit aktiv, *locus standi*, për sa i përket kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë, ekzaminimi i shterjes së mjeteve të rregullta juridike është një element me rëndësi meqë provon konkluzionin e Gjykatës mbi atë se Kërkuesi ka kërkuar një kontroll abstrakt të kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 të KGJK, një e drejtë kjo kushtetuese e cila nuk i përket Kërkuesit.

Për dallim nga rastet e cenimit të së drejtave dhe lirive të njeriut, rastet e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë nuk kërkojnë pasjen e elementit të shterjes së mjeteve të rregullta juridike. Përkundrazi, subjektet e përmendura në nenin 113, paragrafët 2, 3, 4, 5, 6, 8 dhe 9 të KRK janë të autorizuar të bëjnë një gjë të tillë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në këto raste, Gjykata shërben si një forum i fundit dhe ekskluziv për gjykimin e mosmarrëveshjeve të kësaj natyre. Kjo është kështu jo vetëm për faktin se KRK i përmend subjektet e autorizuar për nisjen e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë në mënyrë shprehimore, por edhe për shkak se rastet kur një gjë e tillë mund të kërkohet janë raste të një rëndësie të veçantë shoqërore.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenet 113.7 të KRK, nenin 22 paragrafët 7 dhe 8 dhe nenin 47 të LGJKRK, si dhe nenet 34 dhe 35 të RRPGJKRK, në mënyrë unanime

### VENDOSI

I. *REFUZOHET SI E PALEJUSHME* kërkesa për nisjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës më 27 nëntor 2008.

II. Ky vendim i dërgohet Kërkuesit, zt. Haxhi Thaqi, palës kundërshtare, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

  
Kadri Kryeziu  
Gjyqtar Raportues



  
Enver Hasani  
Kryetar